

## AKT THEMELIMI I SHOQERISE

**Innovador sh.p.k.**

**- Shoqeri me Ortak te Vetem -**

Ky Akt Themelimi nenshkruhet sot, me date 09.12.2021, ne Tirane, nga ortaku themelues i shoqerise se vijon:

- **Znj. Teolanda Hoxha**, shtetase kosovare, lindur me 13.12.1979, ne Peje, me adrese banimi ne Rruga "Leke Dukagjini", Nr.14, Peje, Kosove, me pasaporte nr. P01383674 ("**Ortaku Themelues**" ose "**Ortaku**").

### I. Themelimi

Ortaku Themelues deklaroi themelimin e shoqerise **Innovador sh.p.k.**, nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar ("**Shoqeria**"), e cila themelohet ne perputhje me legjislacioni tregtar ne Republiken e Shqiperise.

### II. Adresa

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: *Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Nr. 24, 1019, Tirane, Shqiperi.*

### III. Kohezgjatja

Shoqeria eshte themeluar per nje kohezgjatje te pakufizuar.

### IV. Objekti

Objekti i aktivitetit te Shoqerise, do te perfshije, por nuk kufizohet ne aktivitetet e meposhtme:

- (i) Prodhimi i energjise elektrike nga burime te rinovueshme dhe cdo burim tjetër;
- (ii) Gjenerimi i energjise elektrike nga burime te rinovueshme dhe cdo burim tjetër;
- (iii) Tregtimi, furnizimi, shitja e energjise elektrike;
- (iv) Ngritja, zhvillimi, ndertimi, manaxhimi dhe operimi i objekteve qe prodhojne energjine elektrike;
- (v) Shit-blerja e te gjitha mallrave dhe sherbimeve;
- (vi) Veprimtari import-eksport ne teresi, e energjise elektrike, pajisje, dhe veprimtari import-eksport per te gjitha mallrat dhe sherbimet;
- (vii) Te gjitha veprimtarite dhe aktivitetet e lejuara nga ligji ne Republiken e Shqiperise.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar per permbushjen e objektit te lartpermendur, Shoqeria mund:

- (i) të kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajshme dhe të paluajshme (përfshirë por pa u kufizuar në blerjen, shitjen, e marrjen dhe dhenien me qera të sendeve të luajshme dhe të paluajshme) si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- (ii) të blejë, në mënyrë të drejtperdrejtë apo të terthortë, interesat në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktivitetit) të ngjashëm me ato të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- (iii) të kryejë aktivitete publike, marketingu e reklamimi; të kryejë aktivitete të ndërtimit, konstruksionit, projektimit, duke marrë licencat përkatëse;
- (iv) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve siç do të konsiderohet e nevojshme;
- (v) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

#### V. Statuti

Statuti i Shoqërisë i bashkëlidhet këtu këtij Akti Themelimi të Shoqërisë.

#### VI. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1,000 Lek, që përbehet nga 1 (një) kuote e vetme dhe e cila zotërohet nga Ortaku i Shoqërisë, si më poshtë vijon:

- **Znj. Teolanda Hoxha**, shtetase kosovare, lindur më 13.12.1979, në Pejë, me adresë banimi në Rrugë "Leke Dukagjini", Nr.14, Pejë, Kosovë, me pasaportë nr. P01383674.

#### V. Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme përbehet nga Ortaku Themelues i Shoqërisë e cila gëzon të gjithë kompetencat e përcaktuara në statutin e Shoqërisë dhe legjislativonin shqiptar.

Administratorja e parë e Shoqërisë emërohet Znj. Teolanda Hoxha, shtetase kosovare, lindur më 13.12.1979, në Pejë, me adresë banimi në Rrugë "Leke Dukagjini", Nr.14, Pejë, Kosovë, me pasaportë nr. P01383674, për një afat prej 5 (peshë) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

*Ky Akti Themelimi u hartua në 3 (tri) kopje.*

#### ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

**Teolanda Hoxha**

TEOLANDA HOXHA